



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2025:004211

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06830801

P.nr.09/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit M.O. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe *Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 367 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1501/23 e datës 13.01.2025, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 10.02.2025, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të pandehurit M.O. dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare av.Kastriot Feka, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 10.02.2025, me datë 11.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: M.O., nga i ati S..., e ëma S..., e vajzërisë H..., data e lindjes..., në ..., ku edhe tani jeton në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, punon si auto limar “..”, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I. Prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 23.08.2023, në Rr. “Vicana” në Vushtri, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët mban në pronësi, posedim dhe kontroll të paautorizuar armen e llojit Zoraki 917-T, me numër serik A3YZR16YS01-21669, një karikatorë të zbrazët të kësaj arme, të cilat i pandehuri i ka dorëzuar vullnetarisht në Policinë e Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II. Me datë 23.08.2023, në Rr. “Vicana” në Vushtri, i pandehuri përdor armën e llojit Zoraki 917-T, me numër serik A3YZR16YS01-21669 në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët, ashtu që i pandehuri kishte shtënë me këtë armë disa herë në ajër, ku arma dhe gëzhojat e shkreputa të armës së lartcekur janë sekuestruar nga Policia e Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 366 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 367 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

**TË PANDEHURIT:** M.O. për veprën penale si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej tetëqind (800) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Ndërsa për veprën penale si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

**URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i armës me nr. serik: A3YZR16YS01-21669, e tipit Zoraki 917-T, dhe një karikator.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1501/23 e datës 13.01.2025 kundër të pandehurit M.O. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 10.02.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri M.O. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

### *Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se duke pas parasysh deklarin e të pandehurit e mbështetur edhe në provat që janë në shkresat e lëndës, e që vërtetojnë gjendjen faktike si në aktakuzë, gjykatës i propozojnë që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, si dhe kjo rrethanë të merret si rrethanë lehtësuese ndërkaq si rrethanë renduese të merret parasysh rrezikun që shkaktojnë këto vepra penale, ndërliiden edhe

me pasojat që mund të rezultojnë sidomos sa i përket veprës nga pika II e dispozitivit, ndërkaq të merret si rrethanë renduese edhe fakti se te vepra nga pika II, përdorimi i armës, respektivisht gjuajtja me armë nga ana e të pandehurit është bërë në një vend ku kanë çasje të qarkullojnë qytetaret si dhe i njëjti nuk ka shtënë vetëm një herë me armë por disa herë, e që nëse i referohemi shkresave të lëndës rezulton këtu se i pandehuri ka shtënë më shumë se 5 herë në ditën kritike, çka nuk e ka mohuar as në fazën paraprake.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshëm me të mbrojturin e tij, i njëjti në mënyrë vullnetare duke ditur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bëj pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës, andaj i propozojnë gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë, dhe me rastin e pranimit të ketë parasysh se i mbrojturi i tij në të gjitha fazat ka qenë bashkëpunues dhe prej momentit të parë që është kontaktuar nga policia e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre dhe vullnetarisht e ka paraqitur armen e tij pranë policisë dhe në të gjitha deklaratimet e ka bërë të ditur se nuk ka qenë në njohuri apo dijeni se arma me gaz është ë ndaluar me ligj, e po ashtu të këtë parasysh të gjitha rrethana lehtësuese siç janë se i njëjti është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, i njëjti njihet si njeri punëtor, i urtë dhe i sjellshëm dhe pa qenë në dijeni se po kryen vepër penale, për shkak të ahengut – martesës së djalit të axhës, të cilin e ka edhe moshatar, ka blerë këtë revole me gazë dhe atë natë e ka përdorur, rrethanë tjetër lehtësuese është edhe se i njëjti edhe sot në këtë fazë të procedurës përsëri e pranon kryerjen e veprës, i njëjti nuk ka as edhe një rrethanë të vetme renduese.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-BD-741, i datës 23.08.2023, , procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin M.O., i datës 23.08.2023, të dhënat e të pandehurit nga data baza e Policisë së Kosovës, fotoalbumi në shtojcë prej 4 fotografive, vërtetimi mbi armën e konfiskuar i datës 23.08.2023, raporti i oficerit i datës 23.08.2023, raporti i shpejt i datës 23.08.2023, raporti policor i datës 23.08.2023, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla,*

*dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Në nenin 367 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm e kryen *“Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”*.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm të nenit 367 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur rrezikshmërinë shoqërore që paraqesin këto vepra penale e posaçërisht duke pasur parasysh se vepra penale është në një ambient ku ka mundur të rrezikohej edhe siguria e personave të tjerë të pranishëm.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro për veprën penale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj burgim i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve për veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ka aplikuar dispozitat e nenit 49 par 2 të KPRK-së e lidhur me dispozitat e zbutjes së dënimit ashti siç është përcaktuar me nenin 71 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPRK-së.

*Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Urdhrin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se *“Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”*.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.09/2025, datë 11.02.2025

**GJYQTARI**

**Agron Maxhuni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën